

K & K COLOR

M51310007T

Date 30/06/2025

KONTRATË DHURIMI

Sot, më date 30/06/2025, palët e mëposhtme lidhin këtë kontratë dhurimi:

DHURUESI

- Z. Saimir Gera, i datëlindjes 30/06/1978, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, identifikuar me ID me nr. personal H80630125N, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar.

PRANUESI

- Z. Ndricim Nezaj, i datëlindjes 16/02/1991, lindur në B. Curri dhe banues në Tiranë, identifikuar me ID me nr. personal J10216072A, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar.

Të lartpërmendurit janë madhorë me zotësi të plota juridike të cilët hartojnë këtë kontratë dhurimi të kuotave si më poshtë:

Dhuruesi Saimir Gera është ortak i shoqërisë K&K Color një shoqëri e regjistruar në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi me NUIS M51310007T, ku zotëron 1 (një) kuote të kapitalit të kësaj shoqërie në masën 50%. Nga kuota që zotëron Saimir Gera në shoqërinë e mësipërme i dhuron Z. Ndricim Nezaj 1 (një) kuote të shoqërisë me vlerë nominale 50,000 (pesedhjetemijë) lekë, e cila përfaqëson 50% të kapitalit themeltar të Shoqërisë.

Pas përfundimit të dhurimit, shpërndarja e kuotave dhe kontributi i ortakëve në shoqëri do të jetë si më poshtë:

- Z. Bujar Nezaj do të kontribuojë në Shoqëri shumën prej 50,000 (pesedhjetemijë) lekë, çka rezulton në zotërimin nga ana e tij e 1 (një) kuote të shoqërisë me vlerë 50,000 (pesedhjetemijë) lekë, e cila përfaqëson 50 % të kapitalit themeltar të Shoqërisë;
- Z. Ndricim Nezaj do të kontribuojë në Shoqëri shumën prej 50,000 (pesedhjetemijë) lekë, çka rezulton në zotërimin nga ana e tij e 1 (një) kuote të shoqërisë me vlerë 50,000 (pesedhjetemijë) lekë, e cila përfaqëson 50 % të kapitalit themeltar të Shoqërisë;

Pranuesit e dhurimit deklarojnë se pranojnë dhurimin e pjesës së kapitalit themeltar që i dhurohet nga Z. Saimir Gera në shoqërinë K&K Color, dhurim ky që i bëhet pa ndonjë shpërblim material apo monetar.

Me lidhjen e kësaj Kontratë Dhurimi, palët në të marrin dijeni se dhuruesit e humbasin të drejtën e pronësisë të pjesës së kapitalit të dhuruar në shoqërinë K&K Color dhe nuk ka asnjë të drejtë ligjore mbi kapitalin e dhuruar. Kjo kontratë do të regjistrohet pranë Qendres Kombëtare të Biznesit.


Kontrata e dhurimit u redaktua në bazë të nenit 761 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë si dhe të ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar.

Palët deklaruan se ky dhurim është bërë me vullnet të plotë dhe pa kundërshtpërblim.

Kontrata e mësipërme si u lexua nga ne palët dhe u pa se në të është shprehur dëshira e vullneti i lirë dhe i plotë e nënshkruajnë pa vërejtje.

Dhuruesi

Saimir Gera



Pranuesi i Dhurimit

Ndricim Nezaj

